



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tuzilaški Savet Kosova/ Kosovo Prosecutorial Council

KPK/Nr. 190/2014
Datë: 29.07.2014

Këshilli Prokurorial i Kosovës në bazë të nenit 110 pika 4 e Kushtetutës së Kosovës, nenit 5 pika 3 e Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës, në takimin e datës 29 korrik 2014, mori këtë:

V E N D I M

- I. Shtyhet afati i dorëzimit të propozimeve (kandidatëve) për pozitën e anëtarit jo prokurorë në Këshillin Prokurorial të Kosovës për dhjetë (10) ditë shtesë, duke filluar nga data 5 gusht deri me datë 14 gusht 2014.
- II. Ftohet shoqëria civile në Republikën e Kosovës, për dërgimin e propozimeve (kandidatëve) për pozitën e anëtarit jo prokurorë në Këshillin Prokurorial të Kosovës.
- III. Propozimet e dërguara (kandidatëve) për pozitën e anëtarit jo prokurorë nga shoqëria civile në Këshillin Prokurorial të Kosovës në bazë të shpalljes së datës 23 qershor 2014, janë të vlefshme dhe do të merren parasysh nga Këshilli Prokurorial.
- IV. Kandidatët e propozuar për pozitën e anëtarit jo prokurorë në Këshillin Prokurorial të Kosovës, duhet të plotësojnë kriteret e më poshtme:
 1. Të jetë shtetas dhe banor i Republikës së Kosovës;
 2. Të ketë diplomë të fakultetit juridik, të pranuar sipas ligjeve të Kosovës;
 3. Të jetë anëtar i shoqërisë civile në Kosovë;
 4. Të mos jetë i dënuar me vendim të plotfuqishëm për veprë penale, me përjashtim të veprave kundërvajtëse;
 5. Të ketë reputacion të lartë profesional dhe integritet moral; dhe
 6. Të ketë përgatitje të lartë profesionale dhe me njohuri nga fusha e të drejtave të njeriut.
- V. Shoqëria civile propozimit të kandidateve për anëtare të Këshillit Prokurorial të Kosovës, duhet të bashkëngjisin edhe dokumentet që mbështesin se kandidati i plotëson kushtet e paraqitura me këtë shpallje publike.
- VI. Këshilli Prokurorial i Kosovës, inkurajon shoqërinë civile që gjatë dërgimit të propozimeve për anëtarë të Këshillit të marr parasysh përbërjen shume etnike të

Republikës së Kosovës dhe parimet e pranuar ndërkombëtarisht të barazisë gjinore.

VII. Përfaqësuesi i shoqërisë civile i cili emërohet anëtarë jo prokuror i Këshillit Prokurorial të Kosovës, emërohet me mandat 5 vjeçar.

VIII. Përfaqësuesi i shoqërisë civile i cili emërohet anëtarë jo prokuror i Këshillit Prokurorial të Kosovës, nga radhët e shoqërisë civile, do të i nënshtrohet rregullave dhe procedurave të përcaktuara me ligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe rregullave të brendshme të miratuara nga Këshilli.

IX. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit.

X. Obligohet Sekretariati i ZKPSH të publikoj këtë Vendim në ueb faqen e KPK-se dhe PSH-së.

Ismet Kabashi
Kryetar i Këshillit Prokurorial të Kosovës

